

**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr. 968/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Nehat Idrizi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) dega në Gjakovë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit, për Rrethin e Dytë të Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 02.12.2013, mori këtë:

## **VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Aleanca Kosova e Re (AKR), dega në Gjakovë.

### **Arsyetim**

PZAP-i ka pranuar një ankesë më datë 01.12.2013, nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR), në të cilën ankesë pretendohet se në Qendrën e vendvotimit 0208C në fshatin Bishtazhin të Komunës së Gjakovës, Komisioneri i PDK-së Nikoll Domgjoni ka shpëputur fletët e votimit përpara se të hyjnë votuesit në klasë, me arsyetimin se dëshiron paraprakisht ti bëjë të gatshme. Sipas parashtruesit të ankesës ky veprim është në kundërshtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) dhe dëshmitarët e vendvotimit kanë raportuar në Prokurori dhe polici

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Me nenin 118.4 LZP-së, parashihet se: *“Mund te apelothen vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i mund ti rishikojë cilindo nga vendimet marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”.*


Pretendimet ankimore të palës ankuese, se në Qendrën e Vendvotimit 0208C në fshatin Bishtazhin të Komunës së Gjakovës, komisionari i PDK-së ka shpëputur fletët e votimit, PZAP-i i konsideron se janë të pabazuara dhe të pa argumentuara sepse dëshmitë e ofruara nuk janë dëshmi bindëse për parregullsinë e pretenduar dhe nuk janë të mjaftueshëm për të

vërtetuar kryesin e supozuar të shkeljes. PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë është i pa argumentuar në prova relevante, andaj në kuptim të nenin 3.6 pika c) të Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it si dhe nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr. 968/2013 më datën 02.12.2013.

Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha



***Këshillë Juridike:*** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.